



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1036/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Skënder Ademi kandidate për anëtarë të kuvendit komunalë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Prishtinë paraqitur kundër Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të publikimit të rezulateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Skënder Ademi kandidate për anëtarë të kuvendit komunalë në Lipjan nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Skënder Ademi kandidate për anëtarë të kuvendit komunalë nga LDK në Lipjan në të cilën pretendon se me datën 03.11.2013 ditën e votimit janë bërë shkelje ligjore, dmth i janë marrë votat në këto vende, Sllovi, Lipjan, Janjevë, Desinoc dhe në disa vende të tjera andaj i lutet PZAP-së të bëjë kontrollimin në vendet e lartëpërmendura në mënyrë që të dhënat t'i jepen të sigurta në të kundërtën do ti drejtohet organeve të tjera.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkelje e tillë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullores së PZAP-I lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 1036/2013 më datën 06.12.2013



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24(njëzetekatër) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.